

“Faktet nuk pushojnë së ekzistuari edhe nëse injorohen,,

Aldous Huxley

50%



Papunësia

45%

Çdo i dyti
1.42 € në ditë



Varfëria

17%

Çdo i pesti
0.93 € në ditë



Varfëria
ekstreme

37%

1.5 Miliard €
në vit



Ekonomia
joformale

1.7

Miliard €
Kosova i nxjerr jashtë çdo vit

Balanci tregtar

Partitë politike
më të korruptuarat
Transparency International



Mungesa e hapësirës politike

FAQE 3

Lorik Bajrami

Rastet më të rënda të korrupsionit

Veprat që kaluan pa ndëshkim

FAQE 6

ORGANIZATA ÇOHU- Gjatë këtyre dhjetë viteve e sidomos që prej krijimit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë ka pasur shumë raste të korrupsionit të mbështetura me fakte, të cilat kanë hasur në injorim të plotë nga institucionet e thirrura për t'i luftuar ato. Institucionet akuzojnë njëra-tjetrën për këtë dështim. Agjensioni antikorrupsion akuzon Prokurorinë dhe anasjelltas, pastaj Qeveria akuzon gjyqësorin dhe ky i fundit ankohet se nuk ka përkrahje. Tërë kjo thjesht përfundon në një bartje të përgjegjësishë nga njëri tek tjetri. E vërteta është se sot nuk kemi asnjë rast të vetëm me të cilin mund të mburrej Kosova për luftimin e korrupsionit e krimit të organizuar dhe këtu ka një dështim të përbashkët kosovaro-ndërkombëtar.

Vijon në faqen 6 →

Proporcionali Fajtor

Fatmir Haxholli

Kur zgjedhjet nuk forcojnë mjaftueshëm urat e komunikimit të vazhdueshëm mes qytetarëve dhe të zgjedhurve të tyre ato nuk mund t'i shërbejnë sa duhet forcimit të qytetarisë. Kur zgjedhjet nuk prodhojnë qeverisje me transparencë dhe llogaridhënie të plotë të politikanëve para qytetarëve, atëherë vota dhe qeverisja nuk ka se si të mos nëpërkëmbet në vazhdimësi. Dhe kur zgjedhjet nuk arrijnë të nxjerrin përfaqësues të profilizuar dhe kompetent në bërjen e politikave, atëherë vendi nuk mund të ndërtoj një elitë drejtuese të bazuar në meritokraci. Kurrë nga asnjë studiues serioz i qeverisjes nuk mund të gjendet interpretimi i marrëdhënies mes atyre që qeverisin dhe atyre që qeverisen si marrëdhënie e pakushtëzuar fisnikërimi, por si marrëdhënie interesash, ndërvaresie, korrigjimi dhe përmirësimi.

Vijon në faqen 5 →

Transparenca e partive politike

Mosdeklarimi i finansave rezulton me politikë klienteliste

FAQE 3

Finansat e partive politike dhe marrëdhënjet e politikës me sektorin privat vazhdojnë të jenë tërësisht jotransparente. Kjo ka bërë që politika kosovare të ketë raporte klienteliste me bizneset dhe të injorojë nevojat e qytetarëve

ORGANIZATA ÇOHU-

Bërja publike e finansimit të partive politike është një aspekt thelbësor i vendosjes së një llogaridhënie dhe një lidhjeje mes politikës dhe qytetarit. Ky problem pothuaj se nuk është fare i rregulluar në Kosovë. Finansimi i subjekteve politike ka mangësi serioze të legjislacionit dhe të institucioneve që duhet ta bartin atë.

Si rezultat i mos-transparencës në finansimin e partive politike në Kosovë mund të duket të jetë shëndërruar në një klientelizëm, kurse programet e tyre shumë pak reflektojnë problemet

me të cilat ballafaqohet elektorati. Nën udhëheqjen e këtyre partive politike, Kosova ka parë vetëm dobësim ekonomik dhe degradim të standardit të jetesës. Premtimet për përmirësimin e standardit të jetesës mbarojnë brenda fushatave elektorale dhe me të marrë pushtetin, partitë politike thjesht vetëm kontribuojnë në thellimin e dallimit në të ardhura në mes politikës e pronarëve të bizneseve të mëdha, në njërën anë, dhe të qytetarit në anën tjetër.

Transparenca e finansimit të partive

Vijon në faqen 3 →



Mungesa e hapësirës politike

Lorik Bajrami

Në Kosovë hapësira për ta vënë në jetë politikën, si mundësi për të marrë vendime, është pothuajse inekzistente. Mungesa e hapësirës për të ushtruar politikë nënkupton jetesën në një “zonë të zhveshur”, e që praktikisht do të thotë de-subjektivizmin e njeriut si qenie me kapacitet vendim-marrës. Të jetosh në një hapësirë ku politika është inekzistente është e barazvlefshme me reduktimin e jetesës në suazat e vegjetimit. Realisht, krejt çka të lejon hapësira apolitike është të jetosh por mos të rrosh. Këtë jetë qenqë qytetarët e Kosovës janë duke e jetuar tash e dhjetë vite.

Por shumë më e rrezikshme se sa mungesa e hapësirës politike është ndoshta vetë simulimi i të bërit politikë. Ky simulim i të bërit të politikës virtualisht na bën subjekt në vendim-marrje por praktikisht na deligjitimon si qenje njerëzore të afta për të vendosur për vetën tonë. Mishërimi më themelor i idesë së simulimit të bërit të politikës janë Partitë Politike. Realisht, Partitë Politike në Kosovë janë subjektet më apolitike në vend ku roli i tyre primarë dhe fundamental ka qenë dhe është vetë simulimi i bërjes së politikës.

Është shumë e kuptueshme se në Kosovë politika tashmë shihet si e mishëruar me Partitë Politike dhe rrjedhimisht ato konceptohen si kanali i vetëm i ushtrimit të saj. Kjo në fakt ka bërë që politika si mundësi për të marrë vendime të monopolizohet nga Partitë Politike dhe si rrjedhojë të shtrëbohet në përmbajtjet dhe format më të stërkeqe të saja. Ky monopolizimi i politikës nga Partitë Politike ka bërë që idenë e ndryshyshimit dhe të shpresës shoqëria e Kosovës t’i bazojë mu tek këto subjekte. Ndryshe nuk mund të shpjegohet fenomeni i zgjedhjeve të kaluara dhe të tashme nacionale ku praktikisht e tërë shoqëria civile (n’ekzistoftë një e tillë) katapulton në Parti Politike.

Politika është baza e çfardo kuptimi të jetës shoqërore. Pa politikë nuk mund të konceptohet e shumë më pak të pretendohet konstruktimi i çfardo shoqërie e cila është e aftë që të ndikojë zhvillimet në dobi të saj. Në Kosovë, ndoshta shumë më e rëndë dhe më e dëmshme se sa krimi i organizuar dhe korrupsioni është pikër-

isht mungesa e hapësirës për politikë. Është pikërisht mungesa e hapësirës për të ushtruar aktivitete politike aduti kryesorë se pse ekziston niveli i tillë i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Përderisa mungesa e hapësirës politike ka shpër edhe në këtë gjendje të apatisë qytetare.

Ekziston një lidhje organike në mes njerëzve të cilët kanë zaptuar shtetin dhe mos-ekzistimit të hapësirës politike dhe kjo lidhje shfaqet sheshazi në disa apsekte të funksionimit të jetës sonë publike. Mundësia për të ushtruar politikë nënkupton edhe aftësinë për të marrë vendime që direkt prekin interesin tonë shoqërorë. Njerëzit që sot bëjnë “politikë” janë pothuajse të paaftë që të vendosin për gjërat substanciale të kësaj shoqërie. Sot, askush nga klasa e establisueme politike nuk mundet që të vendosë në favor të interesit tonë shoqërorë për sa i përket projekteve më kapitale të kësaj shoqërie.

Marrëdhëniet partonizuese që shoqëria kosovare në vazhdimësi ka pasur me faktorët ndërkombëtarë realisht ka qenë përbërsi kryesorë që ka mbyllur hermetikisht hapësirën e bërjes së politikës në Kosovë. Sigurisht që kjo marrëdhënie ka ardhë si pasojë e mungesës së integritetit të faktorit vendorë e cila marrëdhënie më pastaj ka degjeneruar në një relacion skllav-patron. Pikërisht, këtë marrëdhënie e kemi takur çdo herë kur jemi ndeshur me procese fundamentale të shoqërisë sonë. Ambasadorë me ndikim si ai amerikan dhe frances iu kanë dhënë vulë projekteve më kapitale siq janë koncesionimi i Aeroportit dhe Autostrada si projektet më transparente dhe të cilat do të sjellin zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Por sidomos, vizita e ambasadorëve të ndryshëm që iu bëhet Partive Politike në prag të fushatës zgjedhore shpërfaqë ashikare qasjen e tyre partonizuese ndaj shoqërisë sonë. Si ka mundësi që të pretendojmë se po ndërtojmë shtet të së drejtës përderisa përkrahje iu ofrojmë mekanizmave jashta strukturave bazë të shtetit siq janë Partitë Politike e jo mekanizmave të zbatimit të ligjit? Në kohë të zgjedhjeve, përkrahja iu ofrohet mekanizmave që janë të thirrura për ta zbatuar ligjin dhe kështu për të siguruar zgjedhje të drejta dhe fer e jo organizmave



që realisht janë shkelësit më të mëdhej të ligjit siq janë Partitë Politike.

Projekte si Autostrada, Energjia, Telekomunikacioni, por edhe mineralet janë sfera ku realisht do të vuloiset e ardhmja jonë e përbashkët. Fatkeqësisht, e ardhmja e projekteve të tilla vendoset nga faktorë egzogjen e që realisht nuk përfaqësojnë aspak interesat e Kosovës. Klasa politike në këtë kuptim është tërësisht inerte. Kjo për faktin se kjo klasë politike është tërësisht e paintegritet, me kusure dhe rrjedhimisht e zapuar nga këta faktorë egzogjen.

Partitë Politike në Kosovë kanë lidhje organike me krimin. Kjo qartazi shihet edhe me mos transparencës e burimeve të finasimit të tyre. Tashmë një dekadë, publiku asnjëherë nuk ka qenë i informuar me finansimin e Partive Politike. Mirëpo, kjo lidhje e mishëruar e Partive Politike me krimin më së miri shihet në të dhënat empirike që i marrim për sa i përket lidhjes së rritjes ekonomike në një anë si dhe, papunsisë dhe varfërisë në anën tjetër. Nga viti 2004 deri më 2009, Bruto Produkti Vendorë i Kosovës sipas Entit të Statistikave të Kosovës është rritur për 1 miliard euro. Megjithë këtë rritje ekonomike, Kosova vazhdon të mbaj shifra të njëjta të papunsisë dhe të varfërisë siq i kishte përgjatë gjithë këtyre viteve. Kosova është vendi më i varfër në rajon dhe në Evropë ku 45% e popullsisë së saj jetojnë në varfëri përderisa

rreth 17% jetojnë në varfëri ekstreme. Përkthyer në shifra absolute i bie që çdo i dyti kosovarë jeton në varfëri me vetëm 1.42€ në ditë, deri sa çdo i pesti/gjashti jeton në varfëri ekstreme apo rreth 400.000 njerzë jetojnë me nën 0.93 € në ditë. Përderisa, rreth 50% e popullsisë aktive për punë së Kosovës janë të papunsuar.

Është edhe një element shumë i rëndësishëm që mundëson bërjen e politikës e i cili në fakt nuk ekziston fare. Brenda këtij mandati qeveritar, por edhe brenda krejt periudhes së qeverisjes vendore, kemi pa se si në organizmat bazë të shtetit si administrata publike, kompanite publike, agencitë e pavarura e madje edhe sistemin e drejtësisë janë vendosur njerëz që zbatojnë urdhëra të qeverisë, të cilat urdhëra edhe vetë kjo e fundit i merr nga dikush tjetër. Praktikisht, kemi zaptimin e shetit nga formacione para-politike.

Tërë shoqëria kosovare tash e një vit e gjysmë është ulur për t’i drejtuar vesh e sy përkrah edhe një misioni tjetër ndërkombëtar me shpresën se do të fillojë luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit. Shoqëria si një spektator i një “reality show” është duke pritur lajmin se një figurë e rëndësishme e qeverisjes është arrestuar nga zyrtarët e një misioni të huaj. Askush nuk pyet, çfarë do të bëjë gjyqësia kosovare, por a do të dështojë EULEX-i. A ka argument më të madh për mungesën e hapësirës politike sesa ky?

Mosdeklarimi i finansave rezulton me politikë klienteliste



... vijon nga ballina

politike në Kosovë mund të jetë në shkallën më të ulët duke qenë se vit pas viti, subjektet politike janë toleruar në mosdeklarimin e finansave pa asnjë pasojë. Në anën tjetër, Ligji për finansimin e partive politike si dhe ai për zgjedhje nacionale praktikisht kanë sanksione aq të ulëta saqë e bëjnë më atraktive pagesën e sanksionit për fshehjen e finansave sesa deklarimin e tyre. Në anën tjetër, marrëdhënjet jotransparente mes biznesit dhe politikës e kanë bërë të mundshme që të dyja palët t'i ofrojnë shërbime njëra-tjetrës në fusha të cilat nuk janë fare të rregulluara me ligj, siç janë për shembull ofrimi i shërbimeve si formë e shpagimit për fitimin e tenderëve publik në konflikt të interesit.

Pagesa e fushatës nga klientët e subjekteve politike

Një hulumtim i Organizatës ÇOHU! ka treguar një aspekt tjetër të problematikës së finansimit të partive politike e që do jetë shumë i vështirë për tu adresuar edhe nëse kemi një deklaram të vazhdueshëm të të hyrave të partive politike. Fakti që Kosova ka dy degë të pushtetit (ligjvënësën e gjyqësorin) që praktikisht ose i binden ekzekutivit ose nuk e kryejn për ndonjë arsye tjetër funksionin e vet kontrollues ndaj ekzekutivit, pra qeverisë, ka bërë që partitë të shfrytëzojnë tenderët publik si mënyrë indirekte për kthimin e borxheve për kompanitë e marketingut që iu kryejn shërbimet e fushatave.

Gjatë intervistimit nga ÇOHU! të zyrtarëve të disa kompanive që direkt janë marrë me organizim fushatash ka dalur se në trekëndëshin politikë-kompani marketingu- biznese që konkurrojnë në tenderë publik, është ndërtuar një strategji për të fshehur finansimin e fushatave të partive politike. Në kushte anonimiteti zyrtarët e këtyre kompanive kanë pranuar se iu kanë bërë shërbime partive të mëdha për fushatë me kundërshtpërblim minimal në llogaritë bankare të tyre që rrallë herë arrijnë shumat mbi 5000-6000 euro, përderisa shuma enorme janë dhënë para kesh nga vetë zyrtarë të partive politike. Përveç kësaj metode të pagesave për

shërbime të marketingut nga ana e Partive Politike, zyrtarë të kompanive të marketingut i kanë pranuar Organizatës ÇOHU! se një pjesë e majme e pagesave janë paguar edhe përmes kompanive të treta siç janë kompanitë e ndërtimit me arsyetimin se kinse në atë kohë iu kanë ofruar shërbime marketingu kompanive të ndërtimit e jo partive politike. “Ne thjesht iu faturojmë shërbimin tonë të bërë ndaj partive gjatë fushatës, kompanive emrat e të cilave na i dhënë partitë dhe kompanitë pastaj shkruajn faturën për një gjoja shërbim tonin ndaj tyre, të cilin ne në të vërtet nuk e kemi bërë”, thotë ky burim duke shtuar se pagesat me të mëdha vijnë në formë të keshit.

Nëse kjo është një dukuri, atëherë monitorimi i të ardhurave të partive politike bëhet pothuaj se i pamundur për faktin se kjo kërkon një shtrirje më të gjerë të auditimeve dhe një kooperim të përpikët të institucioneve tjera që sigurojnë transparencë siç janë për shembull edhe institucionet që merren me prokurime publike. Në anën tjetër një hulumtim i SAR (Shoqatës Akademike e Rumanisë) dhe Organizatës ÇOHU! ka treguar se një bashkëpunim mes institucioneve të tilla praktikisht nuk ekziston.

Partitë me kosto false të fushatës

Një raport që ÇOHU! ka arritur ta siguroj nga burime e saja e i cili përket zgjedhjeve të fundit parlamentare të vitit 2007 nxjerrë në pah shumë parregullsi të raportimeve financiare të subjekteve politike. Edhe pjesët e raportuara të finansave të partive politike kanë probleme serioze në raportim. Partitë e kanë pasur të vështirë të mbulojnë shpenzimet me dokumente financiare para Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ). KQZ në shumë raste ka vënë re se subjektet politike kanë nën-raportuar shpenzime financiare, ndonëse shpenzimet reale ishin shumë më të larta.

Poashtu, të hyrat financiare në fushatë në vlerë prej dhjetëra mijëra euro të donatorëve kanë mbetur edhe më tutje si anonime, pasi që partitë kanë refuzuar t'i bëjnë publike. Gjithë kjo mostransparencë e subjekteve politike me taksapaguesit kosovarë dhe njëkohësisht duke bërë shkelje të rënda të ligjeve në fuqi është bërë për

shkak të gjobave minimale financiare të përcaktuara ma Ligj.

Neni 6 i Rregullës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 10 /2007, përcaktonte vlerën maksimale të tarifës prej treqind turo (€300) për dorëzim të vonuar të raportit financiar nga subjektet politike brenda 15 ditëve nga afati përfundimtar. Duke u bazuar në nenin 6.5 të Rregullës së Zgjedhjeve 10/2007, Zyra e Regjistrimit të Partive Politike po ashtu ka paraqitur ankesa në Komisionin e Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtresa kundër subjekteve politike për shkak të mosdorëzimit të Raportit të Publikimit Financiar të Fushatës brenda 15 ditëve pas afatit përfundimtar.

Ankesat ishin bërë kundër 49 subjekteve politike për periudhën e para fushatës, kundër 22 Subjekteve për periudhën e fushatës dhe kundër pesë Subjekteve për në raundin e dytë të Zgjedhjeve për Kryetar Komune.

PDK nuk dorëzoi raport financiar

Sipas raportit mbi publikimet financiare të fushatës së subjekteve politike për Zgjedhjet e Kosovës 2007, i përgatitur nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike në kuadër të KQZ-së, PDK ka dështuar të dorëzojë ndonjë raport të publikimit financiar të Fushatës, siç është kërkuar nga rregullat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nr. 10/2007 dhe 14/2007 përfshirë raportet për para-fushatë, periudhën e fushatës, dhe për raundin e dytë të Zgjedhjeve për Kryetar Komune.

Dështimin e partisë më të madhe në vend që të dorëzojë në KQZ raport të publikimit financiar të fushatës nuk e pranon zëdhënësi i kësaj partie, Blerand Stavileci, i cili thotë se për zgjedhjet parlamentare të vitit 2007 i kanë bërë transparente të gjitha të hyrat dhe shpenzimet, ndonëse në raportin e KQZ-së potencohet e kundërta. Megjithatë, në mënyrë që të vlerësohet se a e ka kaluar apo jo PDK-ja kufizimin e shpenzimeve të caktuar nga Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike është detyruar të gjejë metoda tjera që t'i vlerësojë shpenzimet e kësaj partie. Ajo këtë vlerësim e ka bazuar në vëzhguesit e vet të fushatës dhe informatat e

mbledhura nga burimet e tjera.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike beson se PDK në zgjedhjet e fundit parlamentare që janë mbajtur ka shpenzuar 105 mijë e 156 euro për para-fushatë, 504 mijë e 395 euro për periudhën e fushatës dhe 47 mijë e 646 euro për raundin e dytë të Zgjedhjeve për kryetar Komune, duke arritur shumën e përgjithshme të shpenzimeve prej 657 mijë e 197 euro. Partia kishte garuar për Zgjedhje për Kuvend të Kosovës, Zgjedhje për Kuvend Komunal dhe Zgjedhje për Kryetar Komune në (28) Komuna. Bazuar në të gjeturat e Zyrë për Regjistrimin e Partive Politike thuhet se PDK-ja ka shpenzuar nën kufirin e shpenzimeve, që për këtë parti ishte caktuar 1 milion e 433 mijë e 500 euro. Mirëpo, në këtë llogari nuk futen shërbimet që kompanitë e marketingut mund t'i kenë bërë partisë në këmbim të tenderëve publik, dyshim i cili ngelet si valid duke pasur para sysh konfliktin e interesit të disa kompanive që kanë marrë pjesë në tenderë publik siç shifet edhe në pjesën e fundit të këtij raporti.

LDK raportoi 132 mijë euro më pak shpenzime

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në zgjedhjet e vitit 2007 kishte raportuar të hyra në vlerë prej 531 mijë euro. Kur ka raportuar për shpenzimet, LDK ka raportuar një vlerë prej 609 mijë duke mos arritur të shpjegojë këtë ndryshim.

Sipas KQZ-së partia ka dorëzuar gjithë dokumentacionin e kërkuar për shpenzime në periudhën e parafushatës, mirëpo, vetëm 263 mijë e 735 euro për periudhën e fushatës, pavarësisht se ka deklaruar 406 mijë e 578 euro shpenzime gjatë fushatës. Përgjegjësi për finansa në LDK, Lutfi Zharku, thotë se kjo parti i ka dërguar të gjitha raportet e nevojshme në KQZ për zgjedhjet e fundit të mbajtura parlamentare në vend. Ai thotë se në raport janë përfshirë shpenzimet e përgjithshme të partisë, por jo edhe të kandidatëve për deputetë. “Ligji nuk e ka përcaktuar se sa duhet të kufizohen shpenzimet për një deputet”, shprehet Zharku.

Mirëpo, Zyra për Regjistrimit të Partive Politike ka zbuluar se LDK ka shpenzime të nën-aportuara. Sipas KQZ-së, në përgjithësi, LDK-ja ka nën-raportuar shpenzime në vlerë prej 131 mijë e 796 euro. LDK-ja ka pranuar donacione në të holla prej burimeve të ndryshme në tri periudha të ndryshme të raportimit. Partia ka raportuar vetëm vlerën e përgjithshme të donacioneve prej 230 mijë e 609 euro në vend të detajeve të raportimit të “burimi dhe data” e të gjitha donacioneve. Partia nuk ka raportuar sa fonde kanë pranuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë individual. LDK-ja ka raportuar se ka pranuar të hyra 286 mijë e 563 euro prej burimeve të tjera, por nuk është përmendur ku dhe nga kush kanë marrë këto të hyra. Kontributet e pranuar nga Partia pa i publikuar plotësisht identitetet e kontribuuesve, sipas KQZ-së do të konsiderohen si të palejueshme.

AAK s’jep sqarime për shpërputhjet në deklarinimin e finansave

AAK, sipas KQZ-së, ka dorëzuar shumë vonë Raportin Financiar të Fushatës për periudhën e Parafushatës dhe Fushatës 2007, por nuk ka dorëzuar për Zgjedhjet për Kryetar. Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar dy raporte financiare të fushatës më 15 mars 2008 për të dy periudhat të Para-fushatës dhe Fushatës. Ndonëse Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka dërguar rezultatet Preliminare kontrollit për të dy periudhat e fushatës organit më të lartë ekzekutiv të partisë, nuk është pranuar asnjë përgjigje deri në këtë datë.

Valon Tolaj nga AAK pranon se i kanë dorëzuar “pak me vonesë” raportet e kërkuara nga KQZ, por insiston se “me rëndësi është kjo parti i ka dërguar këto raporte”. Poashtu, sipas tij, AAK nuk e ka tejkaluar kufirin e shpenzimeve në fushatë.

AAK a ka pranuar donacione në të holla prej burimeve të ndryshme në dy periudhat e raportimit për zgjedhjet. Shuma e përgjithshme e donacioneve të raportuara prej partisë ishte rreth 93 mijë euro, të gjitha të pranuar nga donatorë individual, mirëpo, shumat prej 10 850 euro nuk është raportuar me detajet e kërkuara.

Vëzhguesit e zgjedhjeve kanë raportuar se AAK ka raportuar kontribute prej 120,000 Euro dhe një kontribuues individual. Veç kësaj, partia ka raportuar të hyra prej burimeve tjera 13,144 euro të pranuar nga Buxheti i Kosovës. Shpenzimet e përgjithshme të

raportuara ishin 265 mijë e 707 euro. AAK nuk ka raportuar asnjë shumë të paguar që kalon 5000 euro për të dy periudhat e fushatës.

AKR dhe LDD s’mund t’i balancojnë shpenzimet

AKR, e udhëhequr nga biznesmeni i njohur Behxhet Pacolli, është një subjekt tjetër që ka pasur potencial për konflikte interesi. Kompania në pronësi të Pacollit ka fituar tenderë të rëndësishëm nga Qeverija prej të cilave tenderi për rindërtimin e Pallatit të shtypit është më i rëndësishmi dhe ka kapur shumën rreth 15 milionë euro. Konflikti i interesit në këtë rast është i një natyre tjetër sepse AKR është një parti që substancialisht qeveriset nga Pacolli dhe investimi në parti është parë si investim në mundësinë e bërjes biznes me sektorin publik në Kosovë. Raportimet e finansave të AKR-së kanë një shpërputhje të konsiderueshme me shpenzimet e gjetura nga vëzhguesit. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2007, Aleanca Kosova e Re (AKR) ka raportuar të hyra të përgjithshme prej 250 mijë euro dhe 283 mijë e 837 euro shpenzime. Selim Pacolli nga AKR thotë se kjo parti e ka paraqitur çdo detaj të të hyrave dhe shpenzimeve në KQZ për zgjedhjet që tashmë kanë përfunduar, ndonëse në raport thuhet partia ka nën-raportuar të hyra prej 226 mijë e 490 euro për periudhën e fushatës.

Sipas KQZ-së, shumica e të hyrave të AKR-së rrjedhin nga donacionet private prej individëve të ndryshëm dhe kjo linjë kap shumën prej 210 mijë euro. Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka rishikuar Fletë Bilancin në fund të periudhës së fushatës me shifrat e raportuara nga Partia dhe këtu ka pasur mosbalancim.

KQZ e mbyllur për informata

Natyrisht institucionet e pavarura janë një nga kontrbuesit e mostransparencës së subjekteve politike rreth finansave të tyre. Zyrtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë refuzuar t’i bëjnë publike raportimet financiare të partive politike, të cilat kanë konkurruar në zgjedhjet komunale të vitit 2009, ndërsa për zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2007 thonë se as që i kanë ato raporte, duke sqaruar se OSBE ka qenë përgjegjëse në atë kohë. Miradije Mavriqi nga KQZ ka thënë se është angazhuar një auditor për vlerësimin e këtyre raporteve, por nuk ka dashur të komentojë më shumë, sepse se këto raporte janë tek auditori, pavarësisht se zgjedhjet e fundit lokale janë organizuar para më shumë se një vit. ”S’mund t’i bëjmë publike raportet e tilla, pa përfunduar punën auditori”,

shprehet shkurt Mavriqi. Ndërsa Merita Mustafa nga Instituti Demokratik i Kosovës(KDI) thotë se 3 herë kanë bërë kërkesë zyrtare në KQZ për t’i bërë publike raportimet e partive politike rreth të hyrave dhe shpenzimeve në zgjedhjet e fundit lokale, mirëpo, sipas saj, KQZ as që është përgjigjur në një kërkesë të tillë. Mustafa potencon se të gjitha partitë e mëdha deri më tani kanë qenë subjekt i gjobave të KQZ-së për mosdorëzim të raporteve dhe se vlera e gjobës ka qenë shumë e ultë. Kjo mostransparencë, sipas saj, ka ndikuar që partitë politike të Kosovës të klasifikohen nga organizatat ndërkombëtare si institucionet më të korruptuara në vend. “Në raportin e Barometrit Global të Transparency International për dy vite me radhë partitë politike kanë dalë si institucionet më të korruptuara në vend. Derisa shkalla maksimale e korrupsionit është 5, partitë kosovare kanë pasur rezultatin 3.8”, shprehet ajo. Sipas saj, ligji i ri e obligon KQZ-në t’i bëjë publike raportet financiare të subjekteve politike, duke i përfshirë këtu edhe donatorët.

Mardhëniet klienteliste

Mediat kosovare kanë raportuar për dhënjen e një tenderi nga ana e

KOSOVA	
Partitë politike	3,8
Parlamenti	3,4
Biznesi/ Sektori privat	3,7
Media	2,3
Zyrtarët publik	3,3
Gjyqësori	4,0
Rezultati mesatar	3,4

qeverisë Thaçi për kompaninë B2 e cila kishte punuar në fushatën elektorale të kësaj partije në vitin 2007. Qeverija pa asnjë tender pat shpërblyer këtë kompani me fondin për festën e shpalljes së pavarësisë në shkurt të vitit 2008. Ky tender nuk është anuluar nga institucionet për prokurim publik edhe përkundër faktit se ka qenë një shkelje e hapur e Ligjit

për prokurim publik. Poashtu një nga kompanitë e përfshiera në fushatën e PDK-së, “D-Line Advertising Studio”, sipas një hulumtimi të gazetës “Zëri”, ka fituar një tender në shtator të këtij viti nga Ministria e Ekonomisë dhe Finansave. Kompania “Advertising Studio D-Lilne” është themeluar pak a shumë në kohën kur edhe ka marrë tenderin prej Ministrisë së Ekonomisë dhe Finansave, pra në shtator të këtij viti. “...i kam ftuar vëzhguesit ndërkombëtar për t’i monitoruar zgjedhjet, për të siguruar se ato do të jenë transparente” ka thënë ish-kryeministri Thaçi në letrën që është botuar në kuadër të fushatës së bërë nga kompania “D-Line”. Mirëpo vështirë se do të ketë vëzhgues që bëjnë transparente konfliktet e interesit që kanë përcjellur fushatat elektorale të PDK-së. Një tender tjetër i madh i është dhënë kompanisë “Saachi & Saachi” degës në Izrael, pak kohë mbasi që PDK ka fituar zgjedhjet nën këshillimin e një grupi të fortë lobingu Izraelit, të prir nga George Birnbaun dhe Arthur Filkenstein, të dy të përfshier edhe në këshilldhënjen për presidentin serb Boris Tadiç dhe ish-kryeministrin shqiptar, Fatos Nano. Nuk janë të rralla rastet kur institucionet dhënë tenderë njëburimor për shumat tepër të mëdha. Një tender i tillë u dha edhe nga KQZ për “The Group” me pronar Blerim Gjoci. Kjo kompani ka fituar plot 780 mijë euro nga Komisioni Qendror Zgjedhor për fushatë për pjesëmarrjen e qytetarëve në zgjedhje. Partia tjetër që ishte në pushtet gjatë kësaj kohe, AAK-ja, njiçet e afërt me dy kompani të mëdha, Elkos Group dhe Dukagjini. Kjo e fundit ka fituar tenderë të rëndësishëm gjatë kohës sa AAK ka qenë në pushtet siç është për shembull fitimi dy herë radhazi i licencës për operatorin e dytë të telefonisë mobile edhe pse në të dy rastet për shkak të presioneve nga jasht Dukagjini nuk arriti ta gëzonte licensen për operatorin e dytë. Mungesa e transparencës në finansimin e partive politike e ka shndërruar pushtetin në Kosovë në një pushtet me përceptimin si të korruptuar e klientelist. Kosova raportohet si vendi shumëfish më i korruptuari në rajon dhe kjo gjithsesi ka të bëjë edhe me faktin se partitë politike nuk kanë transparencë në marrëdhënjet e tyre me bizneset private, me mosdeklarimin e finansave, por edhe me përfshirjen e konfliktetve të interesit në tenderët publik.

1: jo të korruptuara, 5: shumë të korruptuara

Proporcionali Fajtor

... vijon nga ballina

Në shoqëritë dhe sistemet demokratike ekziston një rregull i pa shkruar për rëndësinë e të mbajturit të zgjedhjeve, e ky rregull themelor do të mund të përmbledhëj në atë se: Çfarëdo qeverisje që të kemi, ne përsëri meritojmë qeverisje më të mirë.

Në një sistem dhe shoqëri demokratike qeveria, parlamenti por edhe të gjitha institucionet tjera nuk besohen verbërisht nga ana e qytetarëve. Përkundrazi në mesin e proceseve tjera, zgjedhjet janë instanca e fundit e shpërblimit të një qeverisje të mirë, apo sanksionimit të një qeverisje të keqe. Pavarësisht në rrethana të Kosovës ekziston një opinion i përhapur se deri më tani të gjitha qeverisjet merituan sanksionim. Por përderisa njëkohësisht qëllimi i zgjedhjeve dhe alternimi i forcave politike nuk është riciklimi i dështimeve në politik por është arritja e qëllimeve sikurse është qeverisja e mirë apo zhvillimi ekonomik. Deri sot ky sistem zgjedhor sado që ka pësuar disa ndryshime kozmetike, sado që Kosova ka organizuar shumë palë zgjedhje të cilat fundja kanë një kosto financiare, humbje energjish dhe kohe, përfshirë këtu edhe implikime tjera në lidhje me konsistencën në qeverisje, prapë se prapë ky sistem nuk ka arritur të prodhoj ndryshime të pritura në masë. Pra ne nëpërmes këtij sistemi nuk po prodhojmë qeverisjen që meritojmë.

Vendet e përparuara politikisht dhe me parti politike në të cilat mobilizimi dhe konkurrenca politike nga brenda nuk ndodh vetëm në një para fushatë, por ndodh në vazhdimësi, edhe mund ta kenë komoditetin e përfaqësimit proporcional në shkallë vendi. Por vendet në të cilat partitë politike, më saktësisht organizimi i tyre në terren është një proces i konservuar, deri diku i shkëputur nga elektorati dhe qytetaret, një proces ku qytetari shihet shpesh si numër në kutinë e votimit dhe rrallë si krijesë me pritje, kërkesa, qëllime dhe shqetësime konkrete, nuk do të duhej ta ketë komoditetin e përfaqësimit proporcional sikurse ndodh tek ne.

Vendet me standard të lartë jetësor dhe me zhvillim të hovshëm ekonomik, mund edhe të përballojnë rënie në nivelin e qeverisjes dhe rezultatet e pritura nga ajo, por në rrethana të Kosovës ky sistem nuk ka prodhuar një elitë politike cilësore, dhe si rrjedhojë as qeverisje të spikatur e cila do t'i sillte vendit ndryshime të shpejta në demokratizim, qeverisje të mirë, apo zhvillim ekonomik. Edhe pse debati politik gjatë qeverisjes është i mbushur me doza negativizmi

dhe kritikizmi për dallim nga fushatat zgjedhore në të cilat dëgjohen premtime surrealiste, ende pak kush i qaset apo trajton kulturën politike si dhe sistemin tonë zgjedhor si shkakhtar. Por përderisa përparimi në kulturë politike i një shoqërie është proces i cili kërkon kohë për tu pjekur, një nga hapat e parë i cili mund të ndikojë në sjelljen e ndryshimeve është dizajnimi i një sistemi të përshtatshëm zgjedhor i cili nxjerrë politikanet nga kështjellat e mbyllura partiake në fushën e konkurrencës së mirëfilltë në publik. Në gjithë këtë mes elita politike vazhdon të mirëmbaj këtë sistem, përderisa publiku dhe shoqëria civile mbetet indiferente.

Qytetarëve të Kosovës duke iu ofruar ky sistem elektorale proporcional me një zonë, me pesë kandidatë, duke ja shtuar edhe një 5% (prag pesë përqindësh) u janë bërë tre imponime në përzgjedhjen e tyre. Së pari ata do të duhet të zgjedhin partinë edhe në rast se partitë politike në Kosovë nuk zgjojnë simpatinë e tyre. Së dyti, ata do të mund të përzgjedhin nga lista e partive kandidatet të cilët jo domosdoshmërisht mund të jenë të preferuarit e tyre të parë, të dytë apo të tretë. Dhe së treti, ky sistem zgjedhor jo vetëm se ka zhdukur mundësinë e garimit të kandidatëve të pavarur, por madje ka shtyrë subjektet me simpati të vogël elektorale të kërkojnë azil politik. Në kulm të kësaj skeme zgjedhore, në rastet më të shpeshta listat e kandidatëve nuk janë rezultat i një gare të mirëfilltë brenda partish. Një sistem i mirë zgjedhor para së gjithash do të duhej të synonte që qytetarëve t’iu ofrojë preferenca të tilla në përzgjedhje të cilat i mundësojnë atij përzgjedhjen mes subjekteve politike, mes programeve të përgjithshme apo më specifike, mes një apo disa kandidatëve. Pra në dizajnimin e një sistemi të përparuar zgjedhor ekzistojnë mundësi të cilat do të mund të përmbushnin më mirë nevojën për ndryshimin e qeverisjes por edhe të cilësisë në qeverisje. Dhe kjo nuk është e mundur me riciklimin apo përjetësimin e personaliteteve në pushtet.

Por, siç qëndron aktualisht një sistem zgjedhor proporcional dhe finesat arbitrare të tij, sikurse janë përzgjedhja mes pesë kandidatëve dhe parashikimi i 5% është një përlllogaritje e saktë e kujtdo që ka dashur ta ruaj status quo-n politike të një apo disa liderëve, të një apo disa subjekteve politike që marrëdhënien me pushtetin dhe qëndrimin në pushtet e konceptojë më shumë si marrëdhënie pronësore dhe trashëgimtare se sa si marrëdhënie e atyre që garojnë për të arritur qëllimet politike që ua kanë vënë

vetës, subjekteve apo spektrit politik që përfaqësojnë në një afat kohor. Për ta ky do të duhej të ishte afat garues politik i përkohshëm dhe kalimtar. Një rregull i dytë i zgjedhjeve, në shoqëritë dhe sistemet e avancuara demokratike do të përmbledhëj si diçka që: Ne nuk do të duhet të zgjedhim të vet-përjetësuarit në politikë, por të atillë që vijnë, zgjedhën, realizohen, dhe zëvendësohen në qeverisje periodikisht. Të tillë që nuk kthehen apo mbesin përsëri, por që thjeshtë vijnë e shkojnë në politikë. Duke qenë se ky sistem është kryesisht në funksion të grupeve të ngushta vendimmarrëse në të gjitha partitë të vjetra dhe të reja pa dallim, atëherë është vështirë të presim nga ky sistem që me peshën e votës dhe shtytjen nga elektorati të ndikojë në ndryshime brenda partiake, dhe aq më pak nw ndryshime të dukshme në qeverisje si rrjedhojë. Prandaj një sistem si ky i cili është duke i ngadalësuar ndryshimet në elitën politike dhe qeverisëse në Kosovë nuk duhet të vazhdojë të mirëmbahet në këtë shoqëri.

Një sistem demokratik dhe shoqëri e avancuar garën politike e balancon si garë mes liderëve të dëshmuar si dhe vlerave dhe ofertave politike që ata përfaqësojnë, dhe jo si garë matematike në kuadër të skemave të probabilitetit dhe kombinatorikës. Në rrethana të tilla një sistem si ky i yni prodhon edhe një skemë politike e cila preferencën (votën) politike të votuesit e transformon nga vullneti politik në kalkulim politik në interes të partive dhe jo të elektoratit. Një rregull tjetër i zgjedhjeve nënkupton që elektorati dhe qytetarët presin një adresë të qartë të shumicës dhe opozitës. Me fjalë tjera ndasitë elektorale nuk duhet t’i nënshtrohen apo t’i ngjasojnë një procesi të përzierjes së ngjyrave, apo të transformimit të dritës, siç thoshte Goethe dikur: E verdha është drita e zbutur nga errësira, ndërsa e kaltra është errësira e cila është dobësuar nga drita. Ky sistem elektorale është duke i mbajtur partitë pengë të koalicioneve dhe njëra tjetrës, dhe si i tillë nuk përfaqëson vullnetin e plotë të elektoratit. Ky sistem elektorale deri më sot ka favorizuar tregun dhe tregtimin e vullnetit dhe jo materializimin e tij në kuadër të një shumice të qartë dhe koherente në program dhe qeverisje.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, së paku deri në këto zgjedhje ky sistem elektorale është duke dekurajuar pjesëmarrjen në votim, duke dëmtuar garën politike dhe qeverisjen me legjitimitet të fortë të mbështetur në votimin masiv. Gjithashtu ka dëmtuar edhe krijimin e kulturës dhe skenës politike ku do të kishim përfaqësues politik të cilët gjatë qeverisjes do të sfidonin krerët e partive në rast se ata dështojnë në një apo tjetër

aspekt. Prandaj një rregull i radhës i zgjedhjeve të mira për një sistem politik të përparuar do të nënkuptonte që sado që politikanët brenda një subjekti apo blloku politik të kenë lidhje të forta mes tyre, ata prapë se prapë do të duhej të mbaheshin më fortë për lidhjen me votuesit dhe vullnetin qytetar. Për më shumë, harta e përfaqësimit politik në Kosovë sipas këtij sistemi elektorale, jo gjithmonë i mundëson rajoneve të ndryshme demografike, por edhe dallueshmërive tjera përfaqësim, dhe si rrjedhojë jo gjithmonë përfaqësuesit politik në institucione janë të balancuar në përfaqësimin e Kosovës pa anime dhe favorizime sipas nevojës dhe lidhjeve politike. Në këtë mënyrë ky sistem jo vetëm se mirëmban padrejtësisht lidhjet e dobëta mes të zgjedhurëve dhe elektoratit, por edhe mirëmban përfaqësimin jo koherent të Kosovës sipas hartës demografike dhe sipas dallimeve tjera elektorale.

Për të përmbyllur, si nevojë për ndryshim, pas këtyre zgjedhjeve partia apo koalicioni fitues do të duhej që në bashkëpunim dhe konsultim të ngushtë me partitë opozitare në parlament, duke përfshirë këtu edhe konsultimin e opinionit publik si dhe palët tjera me interes, të inicioj ndryshimin e ligjit mbi zgjedhjet, respektivisht të këtij sistemi elektorale. Kjo sepse qytetari i Kosovës ka nevojë për një politikë të përgjegjshme, llogaridhënëse, transparente, komunikuese. Qytetari i Kosovës ka nevojë për adresë dhe për respektim të vullnetit elektorale sikurse ka nevojë për ri-freskim të energjiave politike në nivel qendror. Por para së gjithash qytetari i zakonshëm dhe elektorati kanë nevojë për adresë të qartë politike të atyre që qeverisin për një mandat. Deri atëherë për dështimet politike ne edhe mund ta fajësojmë këtë sistem, por nuk ka asnjë dilemë që ky sistem nuk përfaqëson interesin më të mirë të shoqërisë dhe vendit ku jetojmë. Nëse nuk kemi politikë dhe qeverisje të mirë, të jeni të sigurt se edhe proporcionali është pjesë a fajit në këtë mes. Të jeni të sigurt se ky nuk është sistemi që ne meritojmë. Në lidhje me këtë sistem dhe ndryshimin e tij ka shumë për t’u thënë dhe mbetet shumë për t’u bërë.

Veprat që kaluan pa ndëshkim

... vijon nga ballina

Në kohën e UNMIK-ut, mungesa e aksionit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar arsyetohej zakonisht me insistimin për “stabilitet politik”. Mirëpo, viti 2010 ka parë momente kur korrupsioni praktikisht është përdorur si një arsyetim për shtytjen e politikës kosovare për të bërë një privatizim të shpejt dhe të pa-rregullt të pasurisë publike. Kjo ka qenë evidente sidomos në përpilimin e Strategjisë për privatizimin e PTK-së dhe Strategjisë për energjinë.

Kur shihet toleranca e skajshme e korrupsionit dhe ndonjëherë edhe mbrojtja e tij nga politika vendore dhe ndërkombëtare shpesh jepet përshtypja që korrupsioni thjesht është shndërruar në një mjet për të arritur dy objektiva. Objektivi i parë i mos-ndëshkueshmërisë së korrupsionit duket të jetë ruajtja e një lojaliteti të politikës kosovare ndaj ndërkombëtarëve, të cilët esencialisht edhe në kohën e UNMIK-ut edhe sot në kohën e EULEX-it kanë autoritetin vendimtar në gjyqësi.

Objektivtjetëri i tolerimit të korrupsionit mund të ketë qenë edhe shfrytëzimi i këtij fenomeni negativ si mjet për të arritur kontrata të rëndësishme për sektorin privat dhe atë sidomos për korporata të huaja.

Ky shkrim është një rezyme e disa nga rastet më të rëndësishme që në Kosovë shkuan pa ndëshkimin e duhur.


Feronikeli: fundi i opozitës

Privatizimi më i rëndësishëm mbas lufte ka qenë privatizimi i Ferronikelit. Ky privatizim është bërë nga AKM, në kohën kur në pushtet ka qenë koalicioni LDK-AAK. Atëbotë ministrat e AAK-së dhe LDK-së, Dugolli, Shatri, e Ali Sadria, kanë qenë anëtarë të Bordit të AKM-së. Fitues i tenderit qe deklaruar Alferon edhe pse me një ofertë më të ulët financiare sesa Adi Nikel. Adi Nikel pat filluar një procedurë gjyqësore kundër AKM-së për shkak të shkeljes së rregullave të tenderit.

Kjo pat ndodhur gjatë vitit 2006/2007 kur PDK-ja ishte në opozitë. Gjatë tërë këtij procesi deri në fillim të vitit 2007 PDK-ja ishte shumë e zëshme në denoncimin e, siç është shprehur

“ministri nën hije i energjetikës” Bajrush Xhemajli por edhe shefi i PDK-së, Hashim Thaci, “tenderit më të korruptuar”.

Në konferencat e rregullta për shtyp që i pati bërë si praktikë PDK-ja me “kabinetin e Qeverisjes nën hije” si opozitë, privatizimi i Ferronikelit qe denoncuar vazhdimisht deri në shkurt të vitit 2007. Pas një udhëtimi që u organizua në Izrael ku Thaçi kishte deklaruar se admiron liderët Natanjahu e Sharon qëndrimi zyrtarë i



PDK ndryshoi drastikisht. Që nga kjo kohë PDK heshti për privatizimin e Ferronikelit dhe përfundimisht u pa se ai ka kaluar në anën e kundërt të asaj që përfaqësonte si opozitë. Kjo arriti në pikë kulmore kur liderët e PDK-së përdorën ndikimin e tyre për të shuar protestën e punëtorëve të Ferronikelit, për të favorizuar ndërmarrjen karshi punëtorëve.

Harmonia perfekte në ndarjen e interesave: telefonia mobile

Tenderi për telefoninë mobile, i udhëhequr nga Autoritetit Rregullativ i Telekomunikacionit (ART), me Anton Berishën shef, një ish-punëtor

i biznesmenit Ekrem Lluka, në vitin 2004 qe anuluar nga PSSP për shkak të dyshimeve për korrupsion. Në këtë tender fitues i licencës qe shpallur konzorciumi i formuar nga Dukagjini por kishte ngelur jashtë një konzorcium pjesë e së cilit ishte Mobiteli sloven dhe Albright Group, gjegjësisht kompania IPKO. Tri vite më vonë, pra në verën e vitit 2007, ky tender u ribë pak a shumë nga e njëjta udhëheqje e ART-së dhe sërish fitues u shpall Dukagjini.

Në këtë rast, mediat patën raportuar gjerësisht për shkeljet të cilat ishin më të rënda se tenderi i vitit 2004. Nuk ishin hapur ofertat publikisht, nuk ishin botuar me kohë kriteret e tenderit, një ofertues ishte lejuar të bënte më shumë sesa një ofertë, etj. Këto shkelje drastike të ligjeve në fuqi mbroreshin nga koalicioni asokohe në pushtet LDK-AAK dhe qenë heshtur tërësisht nga të gjitha partitë politike. Derisa mediat raportnin gjerësisht, PDK-ja, si partia më e madhe opozitare, me një kabinet nën hije “të qeverisjes së mirë”

CROATIA FYR MACEDONIA

SERBIA BOSNIA AND HERZEGOVIN
ALBANIA MONTENEGRO

ALGERIA RUSIA KAZAKHSTAN
MOLDOVA VENEZUELA BOLIVIA
KOSOVA BELARUS ZIMBABWE

pothuajse nuk u shpreh fare për këto shkelje drastike të ligjit.

Përfundimisht disa javë më vonë konzorciumi i themeluar nga Dukagjini i Ekrem Llukës, Koscell, tërhiqet për t’ia lënë licencën konzorciumit të dytë të përbërë nga Mobiteli sloven, Mobiteli sloven/IPKO; Albright Group dhe Faktor Bank-a slovene. Konzorciumi “Kosmocell” ishte skualifikuar nga ART-ja, pasi që kishte dështuar ta paguaj shumën e ofruar për licencë prej 81 milionë eurosh brenda afatit ligjor prej 14 ditësh dhe në vend të saj kompani e preferuar ishte shpallur kompania e IPKO, që për licencën e dytë kishin ofruar 75 milionë euro. Mirëpo me rastin e dështimit të pagesës së shumës së licencës prej 81 milionë euro, ART është dashur ta transferojë në thesarin e shtetit garancionin bankar për ekzekutimin e 16.2 milionë eurove nga “Kosmocell”

si parapagesë, të cilën gjë që 4 vjet nuk e ka bërë. Për mostransferimin e 16.2 milionë eurove nga “Kosmocell” në buxhetin e Kosovës përfaqësues të shoqërisë civile dhe deputetë të pavarur kanë bërë denoncim në prokurorinë e EULEX-it, e cila tashmë ka konfirmuar se ka filluar hetimet për këtë çështje.

Së fundi, përkundër ekzistimit të shumë fakteve për shkeljet në tenderin e dytë të telefonisë mobile PDK si parti opozitare nuk dha as më të voglën vërejtje, por përkundrazi lideri i saj Hashim Thaçi befasishëm u duk në ceremoninë e nënshkrimit të kontratës për operatorin e dytë të telefonisë mobile mbajtur në verë të vitit 2007. Kështu marrëveshjet e biznesit zbuluan se në Kosovë qoftë edhe joformalisht ishte akoma në fuqi koalicioni i gjerë LDK-AAK-PDK.

Kosova e re: unifikimi i politikës kosovare

Koalicioni PDK-AAK që nuk shkrepri në politikë, në tenderin më të madh të Kosovës pat arritur konsensus pa vështirësi. Ish-sekretari i përhershëm i Ministrisë për Energjetikë dhe Miniera, Ekrem Belegu dhe ish-kryeministri i Kosovës, Bajram Rexhepi kanë bërë krejt çfarë është e mundur që “Cez Group” ta fitoj tenderin më të madh në Kosovë ndërtimin e Termocentralit “Kosova C”. Të informuar mirë se ky tender do të votohet edhe në Kuvendin e Kosovës, “Cez Group” ka menduar mirë para se të vinte në Kosovë për ofertim në këtë tender, duke mbledhur rreth vetes njerëz me influencë politike të pozitës edhe opozitës.

Nënkryetari i PDK-së, Bajram Rexhepi ka qenë i punësuar si këshilltar kryesor i “Cez Groupit” në Kosovë. Ish-sekretari i MEM-it nën mandatin e Et’hem Çekut, Eroll Begolli, i cili ka punuar 20 muaj rreth këtij tenderi në ministri, ka qenë drejtor kryesor i CEZ-it në Kosovë.

Në vitin 2006 “Kabineti i Qeverisjes së Mirë” i udhëhequr nga PDK-së kërkonte nga Qeveria e Kosovës të bëhet transparente çështja e dhënies së thëngjillit të minierës së Sibovcit në shfrytëzim investitorit.

Ministria për Energji dhe Miniera e koalicionit LDK-AAK nuk e pat shpalosur projektin për tenderin e termocentralit “Kosova C”, hapjen e mihjes së Sibovcit dhe rehabilitimin e termocentraleve të “Kosovës A”. Përkundër interesimit të madh të investitorëve, detajet rreth këtij projekti ngelnin të fshehura.

Dhënia në shfrytëzim e një miliard ton thëngjill investitorit të termocentralit “Kosova C” me vendim të Qeverisë nën arsyetimin se do të stabilizohet situata energjetike për opozitën atëherëshme ka qenë e papranueshme. Mirëpo fjalët e

mëdha të PDK-së u shuan me ardhjen në pushtet të kësaj partie. Tenderi për “Kosovën C” u vazhdua me po të njëjtën mungesë transparence. Përkundër votimit të Strategjisë për energjinë, me të cilën u vendos që Kosova B t’i kalohet në pronësi investuesit të ardhshëm, asnjëherë nuk u bë e ditur cili do të jetë përfitimi i Kosovës dhe sa aksione do të ketë Kosova në projektin “Kosova e Re”. Kjo strategji qe refuzuar nga Kuvendi i Kosovës në Prill të këtij viti, por vetëm dy javë më vonë pas intervenimit të këshilltarëve të Bankës botërore dhe të FMN-së tek deputetët u votua.

Shteti i biznesit: autostrada dhe aeroporti

Në tenderin për Autostradën qeveria e udhëhequr nga PDK zgjodhi një profil të ulët. Nuk bënte shumë bujë, nuk hapej në diskutime dhe ky tender edhe pse do të arrijë shkallën prej mbi një miliardë euro, për nga mungesa e vëmendjes mund të krahasohej me ndonjë tender për të blerë ndonjë fotokopjues. Sapo kompania amerikano-turke Bechtel & Enka mbaroi punë me autostradën Durrës-Morinë, përfundoi edhe tenderi për autostradën tjetër që do të lidhte Morinën, gjegjësisht kufirin e Shqipërisë me Merdaren, përkatësisht pikën kufitare me Serbinë.

Disa studime të fizibilitetit të bëra nuk e kanë nxjerrë këtë projekt ekonomikisht jo-rentabil. Derisa kriteri themelor i projektit, siç e kishte thënë edhe vetë ministri Limaj, ishte çmimi më i lirë, në një dokument që Ministria e Ekonomisë dhe Finansave e kishte dorëzuar në Bankën Botërore dhe në Komisionin Evropian dhe FMN, pothuaj se e kishte dyfishuar çmimin e këtij projekti nga 700 milionë euro në afër 1 miliardë euro duke bërë thyerje të Ligjit për prokurim, i cili lejon vetëm 10% të shtohet vlera e kontratës pas përmbylljes së procedurave tenderuese. Edhe pse një projekt që do ta fusë Kosovën në deficit serioz buxhetor për disa vite me radhë, qeveria nuk e pa të arsyeshme që këtë projekt ta kalojë në Parlament. Asnjë nga partitë opozitare nuk u dëgjua të fliste apo të kërkonte sqarime në lidhje me këtë projekt apo për dyfishimin e çmimit të tij edhe pse çmimi më i lirë ishte arsyeja pse Bechtel & Enka e kishte fituar konkurrencën me kompani me renome botërore në këtë fushë.

Ky tender i rëndësishëm po ndodhte pak javë pas një tjetër tenderi të rëndësishëm të organizuar nga Qeveria Thaçi. Në një rrethanë tjetër të diskutueshme mediat kosovare ishin mbledhur për të parë ofertat për dhënien me koncesion të Aeroportit të Prishtinës, por gazetarët ishin kthyer nga kjo konferencë shtypi me po aq informacion sa kishin shkuar në të, pra pa asnjë informacion.

Përmbajtja e ofertave do t’i bëhej e njohur medias kosovare dhe opinionit publik kosovar “një ditë tjetër”. Reagimeve dhe kërkesave për sqarime dhe transparencë në këtë proces nuk iu përgjigj asnjëherë qeveria, por në një opinion të shkruar nga ambasadori amerikan në Prishtinë është dhënë garanca e tij personale se ky proces ka qenë në rregull. As sot e kësaj dite nuk është bërë e ditur përmbajtja e ofertave për koncesionimin e aeroportit edhe përkundër faktit se kjo ishte premtuar. Tenderët për koncesionimin e Aeroportit dhe për autostradën Morinë-Merdare kishin filluar pak kohë pasi EULEX-i kishte bërë një seri bastisjesh prej të cilave më e rëndësishmja ishte bastisja në Ministrinë e Transporteve dhe të Telekomunikacionit. Kur EULEX po mbushte opinionin publik me zotime se policia e saj dhe prokurorët kanë evidenca për korrupsion, Ministri Limaj befasisht gjendet në një vizitë në Washington prej nga dërgon një komunikatë për shtyp në të cilën thuhej se do të privatizohej PTK-ja, Aeroporti do jepej me koncesion, do të ndërtohej Autostrada dhe do shitej KEK-u. Në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të përgatitur nga MEF, thuhet se të gjitha të hyrat nga privatizimi i kompanive publike do të hyjnë në financimin e Autostradës, çmimi përfundimtar i së cilës nuk dihet akoma. Këtë qëndrim e ka thënë disa herë edhe kryeministri Thaçi gjatë diskutimeve në Parlament për Strategjinë për privatizimin e PTK-së.

Kauboji në sallën: strategjia e privatizimit të PTK-së

Keqmenaxhimi i PTK-së ishte një nga temat më të rrahura që nga themelimi i kësaj kompanie. Pa bërë asnjë hap për luftimin e keqmenaxhimit dhe heqjen e pengesave për zhvillimin e PTK-së, pas një kohe të gjatë përpjekje për të demantuar këto dukuri në këtë kompani, Qeveria bazoi strategjinë për privatizimin e PTK-së pikërisht në arsyetimin se kompania po keqmenaxhohet. Duke pasur para sysh se Bordi i kësaj kompanie ishte tërësisht politik, keqmenaxhimi dhe korrupsioni në këtë kompani në të vërtet mund të konsiderohet se ishte rezultat direkt dhe qëllim i kësaj qeverie. Kjo mund të shihet në faktin se sot keqmenaxhimi është shndërruar në argumentin kryesor të Qeverisë së Kosovës e veçanërisht të ministrit të ekonomisë Ahmet Shala dhe kryeministrit Thaçi, për shitjen e PTK-së.

Strategjia për privatizimin e PTK-së hodh për votim në Kuvendin e Kosovës në qershor të këtij viti. Për herë të parë në Kuvendin e Kosovës u pa një diskutim më i hapur për

një dokument të rëndësishëm për ekonominë e vendit. Edhe pse ishte e qartë se Strategjia për privatizimin e PTK-së nuk kishte përkrahjen e Kuvendit, kryeministri Thaçi mori një rol udhëheqës në seancën tjetër të Parlamentit, atë të korrikut në të cilën u paraqit kjo strategji. Dy tentime brenda ditës rezultuan të dështuara dhe në fund ndodhi një “kalim në parim” i strategjisë, një praktikë që ndodhë me ligjet por jo edhe me strategjitë.

Pas këtij dështimi Thaçi premtoi se në shtator do të rikthehet Strategjia për një votë përfundimtare pas përfshirjes së vërejtjeve të deputetëve, vërejtje të cilat ishin aq substanciale saqë kërkonin një rishikim të tërësishëm të strategjisë. Strategjia u kthye në tetor dhe prapë u refuzua nga parlamentarët e të gjitha partive përveç atyre të PDK-së. Mirëpo, pas një takimi me ambasadorin Dell, kryeparlamentari Krasniqi e hodhi në votim strategjinë gjatë së njëjtës seancë edhe përkundër faktit se në Parlament nuk ekzistonte kuorumi minimal për votim. Krasniqi injoroi këtë fakt, nuk e verifikoi kuorumin, por kjo çështje mori përmasa tjera kur deputetët denoncuan se votimi ishte bërë vetëm nga PDK-ja dhe minoritetet, pa një kuorum të duhur. Kryeparlamentari tha se do ta kthente në rivotim Strategjinë për PTK-në.

Korrupsioni në Kosovë: a mund të parandalohet?

Që nga vendosja e Kosovës nën administrim ndërkombëtar, gjegjësisht UNMIK-ut, objektivi kryesor dhe më

i rëndësishmi ishte stabiliteti politik. Ky stabilitet politik kërkohej të arrihej me çdo kusht, madje edhe me kushtin e mbylljes së syve përballë korrupsionit dhe përzierjes së politikës në krimin e organizuar.

Pas një dekade të tolerimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar në politikë, nën arsyetimin e ruajtjes së stabilitetit politik, përmasat e korrupsionit dhe krimit të organizuar duket të kenë arritur në një pikë pakthim.

Duke qenë se korrupsioni tolerohej, aktet ndërkombëtar në Kosovë kërkonin nga politikanët vendor një lojalitet dhe bashkëpunim në arritjen e objektivave të tyre në Kosovë. Kështu, proceset shumë të komplikua bashkësia ndërkombëtare i kaloi me një lehtësi. Kjo vlente në negociimin dhe kompromiset rreth statusit, por kjo vlente dhe vazhdon të vlejë edhe në procesin e privatizimit të aseteve publike dhe përgjithësisht të qasjes në ekonomi. Përkundër faktit se për dhjet vjet me radhë nuk u pa ndonjë përmirësim si rezultat i privatizimit, dhe të hyrat për buxhetin nga ky proces ishin larg nga ato të priturat, asnjë akt politik i rëndësishëm nuk guxon të kontestojë këtë proces. Në Kosovë besohet gjerësisht se mosndëshkimi i politikës për korrupsion është duke u shfrytëzuar nga ndërkombëtarët si kushtëzim për të arritur vendimet e kërkuara.

Si rezultat përfundimtar i këtij rrethi të shantazhit reciprok të politikës kosovare dhe ndërkombëtare është vazhdimi i pafund i negociatave për të ardhmen politike të Kosovës në një anë dhe privatizimi i shpejt dhe i pa kriter i aseteve publike në anën tjetër.





MOS MENO

VOTO

DHE BJERI FYLLIT